



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE INTEGRIMIT DHE ASETIVE
SEKTORI I ASETIVE

PROJEKT VENDIM

Nr 17. Datë 27.09.2023

Rishikim i projekt vendimit nr 04, datë 24.08.2021, “Dhënie pëlqimi në parim, për dhënie në përdorim me anë të konkurimit me afat deri 10 vjet, të sipërfaqes prej 735 m2, pjesë e pasurisë nr 546/4, Zk nr 3506, e llojit “Pa fryt”, fshati Stajkë, NJAD Bushat, pronë e Bashkisë Vau Dejës.

Bazuar në nenin 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja “e/1” (ndryshuar), neni 55 pika 4, të ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligji nr 38/2019, ligji nr 8743 datë 22.02.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligji nr 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM nr 246, datë 31.03.2011, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr 68, datë 28.01.2008, për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Bushat të Qarkut të Shkodrës”, në VKM-në nr 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, ndryshuar, Udhëzimin nr 13, datë 26.04.2018, “Për zbatimin e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, si dhe në Çertifikatën e pronësisë për pasurinë nr 546/4, objekt i dhënies me qira, lëshuar me datë 12.01.2023, propozojmë që në mbledhjen e radhës, Këshilli Bashkiak të:

VENDOSI :

1. “Miratimin në parim “Dhënie në përdorim me anë të konkurimit, me afat deri 10 vjet, të sipërfaqes prej 735 m2, pjesë e pasurisë nr 546/4, Zk nr 3506, sipas plan rievimit bashkëlidhur këtij projekt vendimi, e llojit “Pa fryt”, ndodhur në fshatin Stajkë, pronë e Bashkisë Vau Dejës”. Fusha e përdorimit të pronës të jetë për veprimtari në fushën e bujqësisë, blegtorisë dhe agropëpunimit.
2. Efektet: Jep impakt pozitiv në komunitet duke hapur vende të reja pune, si dhe sigurohen të ardhura për Bashkinë, që kthehen më pas në investime publike.
3. Tarifa e qirasë vjetore, afati, si dhe procedura e dhënies në përdorim me anë të konkurimit me të gjithë elementet e saj përbërës, do bëhet në përputhje me parashikimet e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr 13, datë 26.04.2018, “Për zbatimin e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014, për përcaktimin e kriterëve, të procedurës.....”.(sipërshkruar).

HARTOI PROJEKT VENDIMIN

DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE INTEGRIMIT DHE ASET EVE

Konceptoi: P/sek. Ndoc Baqli

Miratoi: Drejtori Bib Miria

KRYETARI
Kristian SHKRELI



Konfirmoi Bazën Ligjore

Sektori Ligjor

Juriste

Fatjona Kovaçi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE INTEGRIMIT DHE ASETERVE
Sektori i Aseteve

RELACION

DHËNIE NË PËRDORIM TË PASURISE SHTETËRORE E LLOJIT "PA FRYT" ME
SIPËRFAQE PREJ 735 m² NË FSHATIN STAJKË, BASHKIA VAU DEJËS

Këshillit Bashkiak Vau Dejës

Të nderuar këshilltarë,

Bashkia Vau Dejës, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, ndër të tjera ka edhe administrimin dhe ruajtjen e tokave dhe kategorive të tjera të resurseve si toka te pafrytshme etj, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, posaçërisht të kaluara në administrim të saj, me qëllim dhënien në përdorim me anë të konkurimit, të tretëve, me objektiv për të siguruar të ardhura për bashkinë, që më pas kthehen në investime publike, si dhe duke hapur vende të reja pune me impakt zbutjen e varfërisë dhe për rrjedhojë rritjen e cilësisë së jetës në komunitet.

Mirëadministrimi i Aseteve publike, është një pjesë e rëndësishme e qeverisjes lokale të mire. Me transferimin e pronave të paluajtshme publike shtetërore në administrimin vendor menaxhimi i asetëve publike bëhet një përgjegjësi e rëndësishme vendore në shërbim të shpërndarjes së zhvillimit ekonomik në të gjithë territorin e Bashkisë.

Bazuar në ligjin nr 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjin nr 8744 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit, në njesitë e qeverisjes vendore", ndryshuar, bashkia jep në përdorim subjekteve të interesuar, pasuritë e paluajtshme në administrim të saj, me kontratë qiraje, duke zhvilluar procedurën përkatëse të konkurimit me të gjithë elementët përbërës të saj, dhe në transparencë të plotë, sipas legjislacionit në fuqi.

Bazuar në çertifikatën e pronësisë lëshuar nga DV ASHK Shkodër, pasuria nr 546/4, Zk nr 3506, ndodhur në fshatin Stajkë, që propozohet të jepet në përdorim rezulton si pasuri e llojit "Pa fryt", e cila futet në grupin e tokave cilësisht të dobëta.

Bazuar në VKM-në nr 54, datë 05.02.2014, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", ndryshuar, si dhe në Udhëzimin nr 13, datë 26.04.2018, "Për zbatimin e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014 (sipërcituar), kategoria e tokave të llojit "Pa fryt", lejohen të përdoren për qëllime bujqësore, blegtorale dhe agropërpunimi, sipas plan biznesit të paraqitur nga subjekti i interesuar, i cili rezulton fitues pas kryerjes së procedurave konkurruese, me të gjithë elementët e saj përbërës.

Vlera dysheme e qirasë vjetore për fillimin e konkurimit sipas Udhëzimit nr 13, datë 18.04.2018, dhe VKM-së së mësipërme, për tokat e pafrytshme, është jo më e ulët se 27 000 leke/Ha në vit.

Ky propozim është paraqitur nje here tjeter nga ana jonë pranë Këshillit Bashkiak me projekt vendimin nr 04.datë 24.08.2021. Pas shqyrtimit nga ana komisioneve përkatëse si dhe diskutimit dhe shprehjes së mosdakordësisë nga ana e disa këshilltarëve bashkiakë, në mbledhjen e KB është kërkuar që ky projekt vendim të rishqyrtohet në një mbledhje tjetër të ardhshme të KB.

Sipërfaqja prej 735 m2, që propozohet të jepet në përdorim me anë të konkurimit është pjesë e sipërfaqes së përgjithshme prej 218 444 m2, e pasurisë nr 546/4, Zk nr 3506, ndodhur në fshatin Stajkë, NJAD Bushat, Bashkia Vau Dejës, e cila në çertifikatën e pronësisë rezulton e llojit “Pafryt”.

Pas miratimit në KB dhe shprehjes së ligjshmërisë nga ana e Prefektit të Qarkut, do vazhdohet me shpalljen ne Buletinin e Njoftimeve Publike, dhe më pas me procedurën e konkurimit me të gjithë elementët e saj përbërës deri në lidhjen e kontratës së qirasë me subjektin fitues.

Për sa më sipër, ju ftojme për të miratuar këtë Projekt Vendim.

Duke ju falenderuar.

Hartuesit e relacionit

Ndoc Baqli



Arjeta Garubi



Denada Dodaj



KRYETARI
Kristian SHKRELI



REPublika e Shqipërisë
Agjencia Shtetërore e Kadastrës

ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI PRONËSIE

PRONARI/BASHKËPRONARËT

Emri i Personit Juridik	Nr. Personal NIPT	Pjesa(-/-)
BASHKIA VAU - DEJES	K56705007O	1/1

Numri i Pasurisë	546/4		
Kodi Unik	3506008103		
Zona Kadastrale	3506		
Lloji i Pasurisë	Pa frut		
Sipërfaqja e pasurisë (m2)	Totali: 218444	Truall: 0	Ndërtesë: 0
Vlera Aktuale e Pasurisë	1		
Adresa e Pasurisë	SHKODER, STAJKE, Rr.: STAJKE		

DREJTORI
Lela Berdica

Lela
Berdica

Digitally signed by:
Lela Berdica
Date: 2023.01.12
02:06:14 +02'00'

Data e lëshimit 12/01/2023



Vulosur elektronikisht nga Drejtorja
Vendore Shkodër
Date: 2023/01/12 11:32:50 +02'00'
K56705007O2023011211324353L1014



PLAN RILEVIMI

PERGATITI

HAMID ÇULIQ

Licensa T.0675/2 Dt. 10.04.2018

Data e perгатитjes: 28.07.2021

ING. TOPOGRAF
 HAMID ÇULIQ
 NR LICENSE T.0675/2

- SIPERFAQE

Sip= 735 m²

IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 3506-3334

NR PASURISE 546-A VOL ___ FQ ___

SHKALA 1:2500

INDEKSI I HARTES : K - 34- 76 -(4 -C)

ADRESA E PASURISE

RRETHI: SHKODER FSHATI: STAJKE-SHELQET

POROSITES: EDUARD PALOCI

